

VENDIM
Nr.667, datë 10.10.2007

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR.666, DATË 26.10.1998 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR DISA MASA LIDHUR ME PROCESIN E LIKUIDIMIT TË NDËRMARRJEVE TË VARËSISË SË ISH-AGJENCISË QENDRORE TË RISTRUKTURIMIT DHE PRIVATIZIMIT TË NDËRMARRJEVE BUJQËSORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.666, datë 26.10.1998 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime e shitesa:

1. Shkronjat “a”, “ç” e “d” të pikës 1 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“a) Arkëtimi i pagesave të kësteve të mbetura, të detyrimeve financiare nga shitja e pasurisë shtetërore të ndërmarrjeve bujqësore, të bëhet në lekë sipas kriterëve të përcaktuara në vendimin nr.704, datë 11.10.2006 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet, si dhe për procedurën e shitjes”.”.

“ç) Debitorët privatë për objektet ndërtimore të kontabilizuara, sipas vendimit nr.403, datë 15.8.1994 të Këshillit të Ministrave ose për rastet e tjera të vëna re më vonë, do t’i paguajnë detyrimet financiare në lekë, 100 për qind. Vlera e çdo objekti ose e një pjese të tij të llogaritet në përputhje me përcaktimet e bëra në pikën 2 të kreut I të vendimit nr.704, datë 11.10.2006 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet, si dhe për procedurën e shitjes”, si dhe në vendimin nr.703, datë 11.10.2006 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e vlerësimit të shitjes së trojeve të ndërmarrjeve shtetërore, që i nënshtrohen privatizimit”.

d) Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit pas marrjes nga drejtoritë rajonale të bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit, të dokumentacionit të vlerësimit të objekteve, që do të shiten, i kërkon Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të përcaktojë çmimin e trullit. Dokumentacioni i plotësuar dhe me çmimin e trullit i dërgohet Ministrisë së Financave (Drejtorisë së Administrimit të Shitjes së Pronës Publike), e cila në bashkëpunim me drejtoritë rajonale të bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit, lidh kontratat e shitjes së objekteve.”.

2. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Debitorët privatë, për paradhënie për shërbime të pakthyera, për paga e dieta të marra padrejtësisht, për vjedhje, shpërdorime e përvetësime etj., për të cilat ekziston dokumentacion i plotë ligjor, do t’i shlyejnë detyrimet financiare, me lekë në dorë, 100 për qind, në përputhje me indeksin e çmimeve, të muajit pararendës, në bazë të të cilit bëhet pagesa.”.

3. Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Privatizimi i pasurisë shtetërore të ndërmarrjeve, në varësi të ish-Agjencisë Qendrore të Ristrukturimit dhe Privatizimit të Ndërmarrjeve Bujqësore (AQRPNB), të bëhet sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave nr.703 e nr.704, datë 11.10.2006 dhe nr.197, datë 20.7.1998 “Për nxjerrjen jashtë përdorimit të objekteve, që nuk ka qenë e mundur të shiten”.”.

4. Pas pikës 5 shtohen pikat 5/1 e 5/2, me këtë përmbajtje:

“5/1. Kur blerësit e objekteve të ish-NB-ve kanë paguar në favor të ish-AQRPNB-së vlerën e këtyre objekteve, por nuk kanë plotësuar kontratat e shitblerjes, për shkak të shkrirjes së Agjencisë, drejtoritë rajonale të bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit në qarqe, pasi të kenë verifikuar pagesarkëtimet e vlerës së objektit, plotësojnë dosjet e privatizimit dhe i dërgojnë për miratim, në përputhje me shkronjën “d” të pikës 1 të këtij vendimi.

Për këto objekte do të merret si i vlefshëm vlerësimi i kryer para daljes së vendimit nr.559, datë 21.11.1994 të Këshillit të Ministrave.

5/2. Nga arkëtimi i detyrimeve financiare prej shitjes së pasurisë shtetërore të ish-ndërmarrjeve bujqësore derdhet, në favor të Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronës Publike, 5 për qind e vlerës, në lekë.”.

5. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha